



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



**Datë:** 02.03.2025

**Numër Protokolli:** 1877/2025

**A.nr.79/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.79/2025, të datës 14.01.2025, të parashtruar nga ankuesi T.Z, kundër organit të punësimit: Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridiko-administrative “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi, 1.1, nenin, 16 paragrafi, 3 dhe nenin, 18 paragrafi, 1 nën paragrafin, 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.79/2025, e datës 14.01.2025 e parashtruar nga ankuesi T.Z, ashtu që, **aprovohet** pretendimi lidhur me shkeljen disiplinore “*flen gjatë orarit të punës*”, ndërsa, refuzohen pretendimet përkitazi me shkeljet tjera disiplinore të konstatuar më aktin e kundërshtuar më ankesë.

**II. Ndryshohet** Vendimi KD.nr.21/2024, i datës 24.12.2024 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ashtu që, masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, zëvendësohet më masën disiplinore “*ndalimi i katër dhjetë për qind (40%) të pagës për një periudhë për gjashtë (6) muaj*”.

**III. Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë për Burime Njerëzore Shërbimin Korrektues të Kosovës, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe të bej kompensimin e 50% të pagës së ndaluar nga data 05.08.2024 deri në 18.09.2024, si dhe kompensimin e pagës së plotë prej datës 18.09.2024 si ditë e largimit nga shërbimi civil e deri në zbatimin e këtij vendimi. Ndërsa, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të behët zbatimi i ndalimit të pagës sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### **A r s y e t i m**

Ankuesi T.Z (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 14.01.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.nr.21/2024, të datës 24.12.2024, të Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 23.01.2025 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, administroi këto prova:*** Ankesën me numër protokollit 145/2025 të datës 14.01.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.nr.21/2024, të datës 24.12.2024, të Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kopjen e ID-së; Vendimin A.,nr.1593/2024 të KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 23.01.2025; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 24.12.2024; Ankesën me numër protokollit 5551/2024 të datës 18.10.2024 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 10.10.2024 për aprovimin e kërkesës për qasje në dokumente; Raportin Hetimor të datës 07.08.2024; Formën e raportimit të incidentit i datës 04.08.2024; Raportin iniciues disiplinor i datës 04.08.2024; Deklaratën e A.H të datës 06.08.2024 dhe 05.08.2024; Deklaratën e datës 06.08.2024 nga L.S; Deklaratën e datës 06.08.2024 dhe 05.08.2024 nga Sh.Sh; Deklaratën e ankuesit e datës 06.08.2024 dhe 05.08.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.10.2024; Përgjigjen në ankesë e datës 24.10.2024; Kontratë punë e datës 01.07.2018;

Përshkrimin e detyrave të punës së Zyrtarit Korrektues; Ftesë për intervistë e datës 15.08.2024; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 05.08.2024; Vendimin KD/021/24 i datës 05.08.2024 i Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor me ankuesin i datës 20.08.2024; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor me A.A e datës 20.08.2024; Deklaratën e datës 26.08.2024 nga P.T; Formën për raportimin e incidentit 11-102024; Vendimin e datës 05.08.2024 për formimin e Komisionit Hetimor; Raportin e bastisjes i datës 24.07.2024; Fleta e numërimit në Pavijonin 5 e datës 03.08.2024; Listë e kontrollimit të rrethojës në shëtitoren brenda pavijonit 5 e datës 02.08.2024; Forma për raportimin e incidentit në polici e datës 03/04.07.2024; Deklaratën e Xh.T e datës 06.08.2024; Deklaratën e G.C e datës 05.08.2024; Deklaratën e D.D të datës 05.08.2024; Deklaratën e D.T të datës 05.08.2024; Deklaratën e B.S të datës 06.08.2024; Deklaratën e L.B të datës 06.08.2024; Deklaratën e Sh.B të datës 06.08.2024; Deklaratën e L.G të datës 06.08.2024; Rekomandimin e datës 05.08.2024; Deklaratën e K.P të datës 04.08.2024; Deklaratën e F.S të datës 04.08.2024; Deklaratën e H.B të datës 04.08.2024; Shënimet e seancës dëgjimore datës 04.08.2024; Raportin e ndërrimit të natës; Fotografi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pjesërisht e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së ankuesi është i punësuar në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe së i njëjti sipas Kontratës së Punës për Kohë të pacaktuar, të datës 01.07.2018, ushtron pozitën *Zyrtar Korrektues*, në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Tutje, sipas shkresave të lëndës, rrjedhë se:

- Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 05.08.2024, nxjerrë Vendimin më numër protokolli 690, për themelim të Komisionit Hetimor, përgjegjës për hetimin e rastit të dyshimit të rrahjes mes të burgosurve në pavijonin 5 në Qendrën Korrektuese në Dubravë, me datë 04.08.2024.

-Më datë 05.08.2024, Mbikëqyrësi i Lartë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se: zyrtari Korrektues Tahir Zeqiraj, më datë 02.08.2024, ka qenë i caktuar në detyrë në Pavijonin 5, kur të burgosurit kanë dal nga dhoma Nr. 6 duke dëmtuar drynin, e kanë hapur edhe dhomën Nr. 7, po ashtu duke e dëmtuar drynin dhe bashkërisht e kanë hapur edhe dhomën Nr. 4 duke dëmtuar drynin dhe i kanë sulmuar të burgosurit e kësaj dhome në krahun V2. Veprime këto që përbejnë shkelje disiplinore sipas nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, 4.5 dhe 4.6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 58, paragrafi 3, nën paragrafi 3.4, 3.11, 3.12 dhe 3.22 të Ligjit Nr. 08/L-13 1për Shërbimin Korrektuar të Kosovës.

-Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 05.08.2024, marr Vendim KD.021/24, me të cilin ka pezulluar përkohësisht ankuesin nga vendi i punës me pagesë prej 50% të pagës bazë.

-Më datë 07.08.2024, Komisioni Hetimor ka nxjerr raportin përfundimtar me numër protokollit 703, përmes të cilit ka gjetur: *të burgosurit e dhomës 6, krahu V2 të Pavijonit 5 rreth orës 01:58 (sipas orës së kamerave të pavijonit 5) kanë hapur kapakun e derës (shpijunktën) dhe me një mjet të fortë (shufër metalike) kanë filluar ta dëmtojnë drynin e derës dhe rreth orës 02:10 (sipas orës së kamerave të pavijonit 5) kanë arritur ta hapin derën dhe kanë vazhduar me thyerjen e drynit të dhomës 7, V2, Pav 5, ku në ora 02:14 kanë arritur ta hapin edhe këtë derë, dhe në ora 02:15 kanë hapur derën e dhomës 4 të po të njëjtit krah. Thyerjen e pjesëve të derës dhe drynave sipas pamjeve të kamerave si dhe deklaratave e ka bërë i burgosur Xh.T, me ndihmën e të burgosurve B.S, L.B dhe Sh.B, dhe duke përdorur mjetet të forta kanë arritur të hapin edhe dhomën 4 dhe kanë filluar ti godasin me mjetë të forta të burgosurit D.T, D.D dhe L.Z. Zyrtari korrektuar Sh.Sh nga krahu Jug i pavijonit 5 i ka dëgjuar britmat dhe ka vepruar në drejtën të krahut V2 ku me të parë të burgosurit në korridor ka dhënë urdhër për alarm tek kolegu A.H, i cili edhe ka kërkuar ndihmë përmes radijolidhjes dhe e ka thirrur kolegu T.Z. ....Zyrtarët korrektues A.H dhe T.Z rreth orës 01:05 shihet se kanë hyrë në zyrën e ndarjes së terapisë dhe nuk kanë dalluar deri rreth orës 02:15 kur edhe janë dëgjuar zhurmat nga përleshja. Komisioni Hetimor, në raportin hetimor rekomandon që të iniciohet procedurë disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se nuk kanë qenë në nivel të detyrës më datë 3/4 gusht 2024.*

-Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më Vendimin KD.nr.21/2024, të datës 18.09.2024, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rendë disiplinore të sipas nenit 58, paragrafi 3, nën paragrafët 3.4, 3.11, 3.12 dhe 3.22 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafët 4.1, 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”.

-Ankuesi, kundër Vendimit KD.nr.21/2024, të datës 18.09.2024, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit me Vendimin A.nr.1593/2024 të datës 11.12.2024, ka anuluar vendimin e kontestuar dhe ka obliguar Komisionin Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës të rishqyrtoj rastin e ankuesit.

-Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës në procedurë të rishqyrtimit, më datë 24.12.2024, ka marr Vendim KD.nr.21/2024, me të cilin ankuesin e ka bërë përgjegjës për shkelje të rendë disiplinore të paraparë me nenin 58 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4, 3.11, 3.12 dhe 3.22 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.nr.21/2024, të datës 24.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se Komisioni Disiplinor nuk ka marr për bazë konstatimet e dhëna sipas vendimit të Këshillit, në atë mënyrë që nuk ka vërtetuar gjendjen faktike ngase nuk ka arsyetuar fatin se pse kam hyrë në dhomën e terapisë kur dihet se vuaj nga sëmundja e Hemoroideve në shkallën e tretë. Nuk janë shqyrtuar fare faktet se asnjëherë nuk kam pasur masë disiplinore të shqiptuar, si dhe është konstatuar në mënyrë të gabueshme se kam qenë duke fjetur në vendin e punës. Kërkon që ankesa të aprovohet, të anulohet vendimi i kontestuar me ankesë dhe të jepet masë proporcionale.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, me theks të veçantë:

Neni 55, përcakton: *“1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësive, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

Neni 56, përcakton: *“1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësive të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësive të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë*

shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

Marrë parasysh faktin së nëpunësit e Shërbimit Korrektues janë nëpunësit civilë me status të veçantë, Kolegji i Këshillit në trajtimin e çështjes i’u referua edhe dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, që rregullojnë procedurën disiplinore të nëpunësve civil në këtë institucion, me konkret Nenin 58, ku përcakton se: “1. Përveç shkeljeve të parapara në Ligjin për Zyrtar Publikë, personeli i SHKK-së përgjigjen edhe për shkeljet disiplinore të veçanta. 2. Shkelje të lehta disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 2.1. është i pasjellshëm apo fyes në fjalë apo në vepra, ndaj te burgosurve, punonjësve tjerë dhe publikut, gjatë detyrës apo në rrethana që kanë të bëjnë me detyrat e tij; 2.2. angazhohet në aktivitete politike që ndikojnë negativisht në kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të paanshme; 2.3. angazhon jashtë procedurës një të burgosur për të kryer ndonjë punë apo për të ofruar ndonjë shërbim pa marrë lejen nga mbikëqyrësi i tij; 2.4. mosmbajtja në mënyrë të rregullt të shkresave dhe të dhënave zyrtare që kanë lidhje me vendin e punës; 2.5. largim nga vendi i punës pa autorizim; 2.6. dy (2) mungesa të pa arsyeshme brenda vitit. 3. Shkelje të rënda disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 3.1.vjedhja, mashtrimi, falsifikimi i dokumenteve zyrtare; 3.2. dëmtimi i pronës; 3.3 .ardhja në punë nën ndikimin e alkoolit apo të substancave narkotike, ose përdorimi i tyre gjatë orarit të punës; 3.4. shkeljet serioze e rregullave të sigurisë; 3.5. zbulimi i të dhënave apo informatave koifidenciale; 3.6. jep deklarata publike për Shërbimin Korrektues, pa autorizim të Drejtorit Përgjithshëm; 3.7. shfrytëzon në mënyrë të palejuar titullin apo autoritetin e tij për përfitim personal; 3.8. jep informata për të burgosurit pa autorizim; 3.9. ngacmimit seksual i ndonjë të burgosuri, të punësuarit apo vizitorit; 3.10. diskriminimi në çfarëdo forme ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë ose tërthorazi kundër të burgosurve, zyrtarëve ose të punësuarve tjerë; 3.11. mos veprimi apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues; 3.12. mosveprimi në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të punës; 3.13. me vetëdije apo me pakujdesi lëshon ose nënshkruan deklaratë të rremë në lidhje me përmbushjen e detyrës; 3.14. duke qenë përgjegjës, apo person me autoritet, injoron apo nuk ndërmerr masa kur një punonjës shkelë rregullat dhe detyrat e punës; 3.15. nuk i raporton autoritetet më të larta mbi çdo mall kontrabandë që zbulon tek ndonjë punonjës, i burgosur apo anëtar tjetër të publikut; 3.16. nga pakujdesia rrezikon ose shkakton dëme fizike apo vdekjen e ndonjë te burgosurit punonjësi tjetër të Shërbimit apo personi tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi; 3.17. përdorë forcën e cila nuk është e kufizuar në intensitetin dhe zgjatjen e saj deri në atë masë që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim; 3.18. përdorë mjetet për përdorimin e forcës në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e Shërbimit Korrektues; 3.19. lejon ose mundëson arratisjen e ndonjë të burgosuri; 3.20. nuk ndërmerr masat e duhura, që ka, kur ndonjë i burgosur shkelë rregulla e brendshme, sulmon një punëtor, të burgosur tjetër, ose anëtarë të publikut; 3.21. nuk jep llogari, mban pa vend, dhe keqpërdorë të hollat e pronën e publikut apo të hollat/pronën e çdo personi tjetër që i bien në dorë gjatë kryerjes së detyrës së tij; 3.22. flenë gjatë orarit të punës; 3.23. detyron, nxit apo përpiqet që me çdo kusht të detyrojë

*një punonjës tjetër të marrë pjesë në punë ilegale apo të palejuar, apo në shkeljen e standardeve të etikës profesionale; 3.24. nuk bën raportimin të menjëhershëm të një incidenti në institucion; Përleshjet me punëtorët tjerë të Shërbimit apo ndonjë anëtar tjetër të publikut gjatë detyrës; 3.25. fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sende të pa lejuara; 3.26. nuk raporton te zyrtarët kompetent, rastet e keqtrajtimit të të burgosurve nga ana e punëtorëve tjerë; 3.27. nuk raporton dhe nuk merr masa ndaj shkeljeve nga të burgosurit, konform dispozitave ligjore; 3.28. fsheh, mban, injoron, dëmton apo asgjëson ndonjë ankesë apo raport të bërë kundër ndonjë zyrtari ose të burgosuri; 3.29. keqpërdorimi i armës zyrtare apo humbja e saj”.*

Rrjedhimisht, sipas Konstatimeve të Komisionit Disiplinor del së më datë 04.08.2024, të burgosurit e dhomës 6, Krahu V2 të Pavijonit 5, rreth orës 01:58 kanë hapur kapakun e derës dhe më një mjet të fortë kanë filluar të dëmtojnë drynin e derës dhe rreth orës 02:10 kanë arritur ta hapin derën dhe të dalin nga dhoma për të vazhduar me thyerjen e drynit të dhomës 7 të pavijonit V2 në pavijonin V5, dhe derës e dhomës 4 të njëjtit krah, ku futën në dhomë dhe godasin më mjete të forta të burgosurit D.Torbanqe, D. Demi dhe L Zymberi. Ndaj, ankuesi si zyrtar korrektues ka dështuar, në kryerjen e detyrave funksionale më përgjegjësi, pasi që i njëjti ka qenë i ngarkuar për mirëqenien të burgosurve dhe së në atë moment ku kishte ndodhë ngjarje sipas viedoincizimeve të kamerave të sigurisë ishte brenda në zyrën e teknikut medicinal e cila zyrë nuk është e dedikuar për zyrtar korrektues dhe pas dhënies së alarmimit nga zyrtaret tjerë për incidentin i njëjti vërehet duke dal nga zyra e teknikeve që lenë të nënkuptohet së ka qenë duke fjetur gjate orarit të punës, dhe së në vlerësimin e Komisionit Disiplinor këto veprime dhe mosveprime të ankuesit përbejnë shkelje të detyrave të punës sipas nenit 58 par.3 nën par.3.4, 3.12 dhe 3.22 të Ligjit Nr.08/L131 për Shërbimin Korrektues gjithësisht shkelje të rëndë disiplinore “mos veprim apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues” “mosveprim në pajtim më ligjin, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të punës” dhe flenë gjatë orarit të punës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i aktit të kontestuar në ndërlidhje më provat materiale të lëndës konstaton së Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor me të drejtë ka vërtetuar së ankuesi në kohën e ngjarjes së datës 04.08.2024, nuk ka ushtruar detyrën e tij lidhur me monitorimin dhe kontrollimin e lëvizjeve dhe aktiviteteve të burgosurve brenda institucionit në këtë rast në Pavijonin V, pasi që i njëjti në kohën e ngjarjes ishte në zyrën e terapive( teknikeve), fakt ky i pohuar edhe nga vet ankuesi me arsyetimin se vuan nga hemoroidet, veprime këto që kualifikohen si shkelje disiplinore sipas nenit 58 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4, 3.11, 3.12 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës. Mirëpo, në vlerësimin Kolegjit, Komisioni Disiplinor nuk ka argumentuar saktë shkeljen disiplinore “ flenë gjatë orarit të punës” , sepse i njëjtit vetëm hamendeson e jo të ketë vërtetuar si fakt së ankuesi ditën kritike kishte fjetë gjatë orarit të punës, dhe për tepër një fakt i tillë nuk është konfirmuar as nga Komisioni Hetimor, andaj në mungesë të provave, ankuesi nuk mund ti vihet në barrë shkelja disiplinore “flenë gjatë orarit të punës” sipas nenit 58 par.3 nën paragrafi 3.22 të Ligjit Nr.08/L131 për Shërbimin Korrektues, kështu që edhe pretendimi ankimor referuar kësaj shkelje është i bazuar.

Andaj, në mbështetje të gjendjes faktike të vërtetuar si më sipër, rrejdhimisht pasi që sic u tha më sipër së ankuesi është përgjegjës për shkelje disiplinore sipas nenit 58 par.3 nen paragrafi par.3.4, 3.11 dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L131 për Shërbimin Korrektues, si dhe marrë për bazë faktin së ankuesi nuk ka në fuqi ndonjë masa disiplinore, atëherë, Kolegji erdhi në përfundimin, së masa disiplinore e shqiptuar më vendimin e kontestuar nuk është në raport me shkeljet e konstatuara sikurse në këtë vendim, kështu që, mbi këtë gjendje aprovoj ankesën pjesërisht, duke ndryshuar Vendimin KD.nr.21/2024, të datës 24.12.2024 të Komisionit Disiplinor, të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ashtu që, masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, zëvendësohet më masën disiplinore “*ndalimi i katër dhjetë për qind (40%) të pagës për një periudhë për gjashtë (6) muaj*. Kurse, obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë për Burime Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit si në pikën II të dispozitivit të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, në mënyrë që ankuesin ta kthejnë në vendin e tij të punës si zyrtar Korrektues, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe të bej kompensimin e 50% të pagës së ndaluar nga data 05.08.2024 deri në 18.09.2024, si dhe kompensimin e pagës së plotë prej datës 18.09.2024 si ditë e largimit nga shërbimi civil e deri në zbatimin e këtij vendimi. Ndërsa, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të behët zbatimi i ndalimit te pagës sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

Theksuar si më sipër, Kolegji vendosi si në dispozitiv të vendimit në mbështetje të përcaktimeve ligjore nenit 18 paragrafi, 1 nën paragrafin, 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 71 paragrafi 7 dhe 9 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

*Lënda me numër A.nr. 79/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

### **Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit, T.Z;*
- *Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*